

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“LOBBYTECH” SHPK

Bazuar në vullnetin e ortakëve themelues dhe mbështetur në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011 vendoset si me poshtë:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot më datë 20.05.2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “Lobbytech” shpk Themeluesi i shoqërisë “Lobbytech” është Z. Mario Fejzaj, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 04.12.1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID nr.034117697 dhe nr.personal: I61204035L, i cili redaktoi këtë Akt-Themelimi, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

“Kryerja e veprimtarive në fushën e teknologjisë së informacionit, konsulence në fushën e IT, programim dhe mirëmbajtje të programeve kompjuterike dhe sistemeve software, aktivitet në fushat e reklamave online, shërbime webdesign, programime kompjuterike, krijimi dhe menaxhimi i websiteve”

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga “Muhamed Gjollësia”, Sheshi Karl Topia, Tirana Ring Center, kati i 5, objekt me nr.pasurie 3/22, Zona Kadastrale 8210, Tiranë, Tirane, Shqipëri”.

Kreu II

Kapitali i shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themelor i shoqërisë është caktuar në shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon :

Lloji i kontributit është në para në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë si më poshtë;

- Z. Mario Fejzaj, është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 100 % (njëqind për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar teresisht nga ortaku i shoqërisë.

Kreu III
Administratori i shoqërisë.
Neni 6
Emerimi dhe kohezigjatja e Administratorit.

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare (5 vjet), në pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Adminstrator i shoqërisë "Lobbytech" sh.p.k. është Z. Mario Fejzaj, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 04.12.1986, madhër, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID nr.034117697 dhe nr.personal: I61204035L.

Kreu IV
Dispozitat Përfundimtare.

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit tregtar.

Modalitet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar. Ky akt themelimi është përpiluar në tre kopje me vlerë të njëjta me origjinalin.

Tiranë, më datë 20.05.2024.

ORTAKU THEMELUES

MARIO FEJZAJ


